

Kisha e Shën Thanasit, pjesë e itinerareve të turizmit kulturor



Përfundon restaurimi i një ndër kantierëve më sfiduesë të ndërmarra nga Instituti i Monumenteve të Kulturës përgjatë vitit 2018.

Kisha e Shën Thanasit, monument kulture i kategorisë I, e degraduar prej dekadash nga mosndërrhyrjet në të, si dhe dëmet e pësuar nga tërmeti i vitit 2017, sot, falë projektit të restaurimit të hartuar nga Instituti i Monumenteve të Kulturës, rikthehet në jetë jo vetëm nga ana strukturore, por edhe si pjesë e itinerareve të turizmit kulturor.

Projekti i restaurimit, pjesë e programit “Rrugët e Besimit”, bëri të mundur konsolidimin e çarjeve në muraturë, ringritjen e kolonave, kupolave dhe qemerëve me strukturë guri, ringritjen e murit anësor në pjesën jugore të kishës, ringritjen e çatisë si dhe kryerjen e një sërë sistemimesh të jashtme. /a.a/ j.p/

ATSH